



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:112795

Datë: 21.06.2022

Numri i dokumentit: 03157002

C.nr.780/2021

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses A. Xh., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat në Gjilan, me adresë Rr.” Bulevardi i Pavarësisë” H-35, K-2, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Musë Gjergjaj, me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar dhe vlera e kontestit 1,281.18€, pas shqyrtimit kryesore publike të mbajtur në prezencë të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të paditurës, më datë 08 qershor 2022, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.Xh., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses A. Xh. nga Gjakova, në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj vlerën e tri pagave bazë, shumën prej 1,131.00€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga datë 07.06.2021 (datë e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të prej 259.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmarimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditëses mbi shumat e gjykuara, dhe atë që në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj shumën prej 150.18 €, si e pabazuar.

#### A r s y e t i m

Paditësja A.Xh., nga Gjakova, përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. Fadil Sinanaj, në këtë gjykatë me datën 07.06..2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjakove, për kompensimin e shumës në vlerë prej 1281.18 euro në emër të shpërblimi jubilar për 30 vite të përvojës së punës. I autorizuari i paditësit në padi, gjatë shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht QKMF në Gjakovë, në pozitën si Infermiere në QKMF- 1-Qabrati, Gjakovë, ku aktualisht i ka bërë 31 vite të përvojë pune nga

çka rrjedh se e njëjta e ka mbushur kushtin ligjor për pagesën tri pagave mujore në emër të shpërblimit jubilar i parapare në Kontratën Kolektive Sektoriale, përkatësisht neni 17 par. Nën par 3.3. Tutje ka shtuar se nga lista e pagave, vërtetohet fakti se në muajin shtator të vitit 2021, paditësi pagën mujore e ka pasur në shumën prej 427.06 euro. Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesa e paditëses të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses, të ia paguaj shpërblimin jubilar në shumë prej 1,281.18 euro, në vlerë të tri pagave mujore të saj dhe atë me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së, duke filluar nga dita e paraqitje së padisë e deri në pagesën definitive

Shpenzimet procedurale në këtë çështje gjyqësore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë: për përpilimin e padisë 104,00 € dhe për pjesëmarrjen në një seancë 135,00 € e parapara sipas tarifës të Odës së Avokatëve, ndërsa në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 30,00 €.

E paditura me përgjigje në padi të parashtruar në gjykatë me datën 20.08.2021 dhe përmes të autorizuarit të saj i cili në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes dhe fjalën e tij përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar. Kjo për faktin se kërkesë padia është e pa bazuar me ligj përkatësisht me ligjin e punës, po ashtu të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, pasi e njëjta nuk është nënshkruese e kontratës kolektive sektoriale. Në këtë rast padia ka qenë dashur ti drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë e jo Komunës së Gjakovës. Shtoj faktin se padia është e parakohshme pasi që nuk janë shtjerrë të gjitha mundësit ligjore të parapara me ligjin e punës në procedurën administrative, e po ashtu kërkesëpadia nuk është parashtruar ashtu siç parashihet me nenin 17 par.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale. Më tutje ka theksuar se përvës bazës e kundërshtojmë edhe lartësinë e kërkesëpadisë pasi që në pagën e kërkuar janë llogaritur edhe shtesat, e që sipas listës së pagës për paditësin, paga bazë është në lartësi prej 397.00 euro. Andaj mbi kështu bazë i propozojë gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe për të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor publik bëri administrimin e të gjitha provave të dhe atë: Kontrata e punës me numër 241 e dt. 22.03.2012, Vërtetimi me nr. 201/31 i dt. 25.05.2021, Lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Prill 2021.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga kontrata e punës me Nr.241 e datës 22.03.2012 gjykata vërtetojë faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht QKMF Gjakovë në detyrat e punës si Infermiere QKMF-1-Qabrat, Gjakovë.

Me Vërtetimin e lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me Nr.201/31 i datës 25.05.2021, gjykata vërtetoj faktin se paditësja i ka 30 vite përvojë punë pranë të paditurës. E

njëjta realizon të hyra nga paga bazë në vlerë prej 377,00€ e përcaktuar sipas listës së pagave e me numër BL8381 Buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata gjenë se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj).

Me neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: *“KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor”*, ndërsa me nenin 17 par. 3 pika 3.3, të KKS parashihet se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri pagave mujore të tij”*, ndërsa par. 4 i këtij neni parashihet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Gjykata vendosi si në pikë I të dispozitivit të këtij aktgjykimi pasi që nga provat e administruara dhe të elaboruara si më lartë, gjeti se paditësja tek e paditura i ka mbi 30 vite përvojë punës, fakt ky i vërtetuar përmes vërtetimit të lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me Nr.201/31 i datës 25.05.2021 dhe rrjedhimisht e njëjta i ka plotësuar kushtet e parapare me nenin 17 par.3 pika 3.3 të KKS, për të qenë përfituese e shpërblimi jubilar në vlerë të tri pagave bazë, mirëpo të njëjtës nuk i janë paguar nga ana e të paditurës. Lartësinë e pagesë bazë në shumë prej 377,00€, gjykata e vërtetoi sipas listës së pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për muajin prill 2021. Për faktin se paditësja ende vazhdon të punoj te e paditura, rrjedh se si punëdhënës i fundit për të njëjtën është Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me seli në Gjakovë.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e ka rolin e kreditorit kurse i padituri rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën si në pikën I të dispozitivit të dispozita të aktgjykimit.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se nuk ka legjitimitet real pasiv për faktin se nuk janë nënshkruere të kësaj kontrate, gjykata vë në dukje se Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kanë marrë përsipër që për stafin shëndetësor të rregullohen raportet që parashihen me këtë kontratë. Në kuptim të kësaj, të punësuarit në sektorin e shëndetësisë nuk mund të vlerësohen ndaras, por se ata janë të punësuar në një sistem unitar të shëndetësisë, duke përfshirë nivelin qendror dhe lokal. Prandaj pretendimi për t’iu shmangur

pagimit të obligimeve të marra përmes KKSSH, do të ishte në kundërshtim me atë që është zotuar Ministria e Shëndetësisë.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur prej dt. 07.06.2021 nga dita e parashtrimit të padisë.

Në anën tjetër, me nenin 55 par.2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , parasheh se “i punësuari ka të drejtë për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”, ndërsa neni 17 par. 3 pika 3.3 i KKS-së, thotë i punësuari ka të drejtë e realizimit të tri pagave bazë e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga. Pra ky përcaktim ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë, dhe shtesa nga paga. Mbi këtë bazë gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht prej 150.18 € ( që përfshinë shtesën në shëndetësi), pasi që gjykata e vlerësoi se paditëses i takojnë tri paga bazë te paraparë si në listën e pagave (377.00€), dhe jo duke përfshirë shtesat që i ka pranuar nga e paditura. Kjo për faktin se shtesat tjera nga paga, duke përfshirë bonuset etj., të punësuarit i takojnë kur ai gjatë angazhimit në detyra të punës arrin të realizoj shtesat në ushqim, punë jashtë orari etj.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, por gjeti se të njëjtat në këtë çështje juridike kontestimore nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe, nga ajo që ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 259.00€. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104,00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësit në një seancë, shuma në vlerë prej 135,00€ ( të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.780/2021 datë 08 qershor 2022

G j y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

Numri i lëndës: 2021:112795  
Datë: 21.06.2022  
Numri i dokumentit: 03157002

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.